



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. 139/0/2

Maliq, më 12.8.2024

PROJEKT - VENDIM - 14 R. 6

Për

" Limit karburanti (gazoil) për kamionin e ri të bashkisë"


Në mbështetje të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, gërma dh), ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 "Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore ", ligjit nr. 68/2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", mbështetur në vendimin nr. 138 datë 26.12.2023 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit për vitin 2024 " Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", i kërkoj Këshillit të Bashkisë:

1. Miratim Limiti prej 1000 litra gazoil/ në muaj për kamionin e ri të bashkisë.
2. Fondi për mbulimin e kësaj sasive të mbulohet nga buxheti i miratuar për karburant për mjetet e bashkisë në buxhetin e vitit 2024 ;
3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë mbas miratimit.

Konceptoi : A.Muka

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ**  
**Drejtoria e Financës dhe Buxheti**

Num: 3910/2

**RELACION**

“Për miratim limit gazoili për kamionin e ri të bashkisë“

**Të nderuar këshilltarë !**

Kërkesa ka të bëjë me vendosje limiti për kamionin e ri që Bashkia Maliq tashmë ka blerë me fondet e buxhetit të vitit 2024 të miratuara nga ana Juaj .

Për përballimin e këtij limiti dhe kësaj sasive gazoili për periudhën Shtator 2024 e në vazhdim nuk ka nevojë për buxhet shtesë pasi do të përballohet nga fondi i miratuar për këtë zë në buxhetin e vitit 2024 .

Sqarojmë se përlllogaritjet e gazoilit në fillim të vitit janë bërë me çmimet në atë moment ( 211 lekë/ litër) dhe pasi është zhvilluar procedura e prokurimit dhe duke parë çmimet gjatë vitit dhe në këtë moment në doganë kemi rezerve për ta mbuluar këtë limit pa rritur fonde.

Kamioni do të përdoret për transporte të ndryshme por puna kryesore e tij do të jetë transport çakëll nga zona Bregas, Zvezdë në drejtim të rrugëve të parcelave.

Faleminderit

Drejtor i Financës dhe Buxhetit

Almira MUKA

**KRYETARI I BASHKISË**

